

شيخ الإسلام محمد بن عبد الوهاب

# القواعد الأربع

شرح سلسلة الشیع عبد العزیز بن باز

# Katër Rregullat

Shejkhul-Islam Muhammed Ibën 'Abdil-Uehhab

Me komentet e dijetarit të madh  
'Abdul-'Aziz Ibën Baz



بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ



**Titulli origjinal i librit: القواعد الأربع**

**Titulli në shqip: "Katër Rregullat"**

**Autor:** Muhammed Ibën 'Abdil-Uehhab

**Komentuesi:** 'Abdul-'Azijz Ibën Baz

**Përkthyesi:** Alban Malaj

**Botuesi:** [www.selefi.org](http://www.selefi.org)

**Mail:** [radioselefi@gmail.com](mailto:radioselefi@gmail.com)

**Faqja e Internetit:** [www.selefi.org](http://www.selefi.org)

**ISBN:**

Copyright © 2015

Çdo e drejtë e përshtatjes dhe e riprodhimit të këtij materiali i takon vetëm botuesit Selefi.org

# Katër Rregullat

Shejkhul-Islam  
**Muhammed Ibën 'Abdil-Uehhab**

## **Parathënie:**

Me Emrin e Allahut, të gjitha lavdet janë për Allahun, lavdërimet dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të Dërguarin e Allahut, si dhe mbi Familjen e tij dhe Shokët e tij.

E më pas:

Këto janë katër rregullat për të cilat ka tërhequr vëmendjen autori – Allahu e mëshiroftë –, të cilat janë rregulla të rëndësishme.

Dhe kush arsyeton dhe i kuption ato mirë, ka për ta kuptuar fenë e mushrikëve (idhujtarëve) dhe ka për ta kuptuar fenë e Muslimanëve.

Dhe shumica e njerëzve nuk i kuptojnë këto rregulla, prandaj atyre iu

pështjelluan çështjet dhe adhuruan në vend të Allahut varret, të varrosurit në to, njerëzit e devotshëm, pemët dhe gurët, ndërkokë që ata mendojnë se janë në udhëzim, për shkak të injorancës së tyre për realitetin e Teuhidit dhe realitetin e Shirkut.

Dhe autori i këtyre parimeve është dijetari, Imami, Muhammed Ibën ‘Abdil-Uehhab – Allahu e mëshiroftë –, ripërtëritësi i simboleve të fshira të Islamit në këtë gadishull, në gjysmën e dytë të shekullit të dymbëdhjetë, i cili vdiq në vitin 1206 të hixhretit Pejgamberik.

## **Tha autori – Allahu e mëshiroftë –:**

“Unë i lutem Allahut, Më Bujarit,  
Zotit të Arshit Madhështor, që të  
kujdeset për ty në këtë botë dhe në Botën  
Tjetër, që të të begatojë kudo që të jesh  
dhe të të bëjë prej atyre që janë  
falenderues kur u jepet, të duruar kur  
sprovohen, dhe që kërkojnë falje kur  
bëjnë gjynah, sepse me të vërtetë këto të  
treja janë shenja të lumturisë.”

*Shpjegimi i dijetarit bujar, ‘Abdul-‘Azijz Ibën Baz – Allahu e mëshiroftë –:*

Thotë autori – Allahu e mëshiroftë –:

“Unë i lutem Allahut, Më Bujarit, Zotit të Arshit Madhështor, që të kujdeset për ty në këtë botë dhe në Botën Tjetër, që të begatojë kudo që të jesh dhe të bëjë prej atyre që janë falenderues kur u jepet, të duruar kur sprovohen, dhe që kërkojnë falje kur bëjnë gjynah, sepse me të vërtetë këto të treja janë shenja të lumturisë.”

Pra, autori bashkon në këtë parathënien e tij, dhënen e dobisë me bërjen e du’asë për nxënësin, dhe kjo është prej këshillimit të sinqertë, që të lutesh për nxënësin që të ketë sukses dhe që t’i bësh dobi atij. Dhe s’ka dyshim se

nëse Allahu e pranon këtë du'a për nxënësin, ai ka për të qenë i lumtur.

Fjala e tij: "...dhe të të bëjë prej atyre që janë falenderues kur u jepet, të duruar kur sprovohen, dhe që kërkojnë falje kur bëjnë gjynah, sepse me të vërtetë këto të treja janë shenja të lumturisë."

Sepse këto tre cilësi janë shenja të lumturisë. Nëse Besimtari tregon kujdes për këto tre cilësi, atëherë e ka arritur lumturinë, sepse ai e falenderon Allahun për atë që Ai i ka dhënë, duke zbatuar urdhërat e Tij dhe duke braktisur ato që Ai ia ka ndaluar; dhe nëse bën gjynah kërkon falje dhe pendohet tek Allahu. Kështu është çështja e Besimtarit: nëse i jepet, falenderon, nëse sprovohet, duron dhe nëse bën gjynah, kërkon falje.

Prandaj thotë Pejgamberi – *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* –:

عَجَباً لِأَمْرِ الْمُؤْمِنِ، إِنَّ أَمْرَهُ كُلُّهُ خَيْرٌ، وَ لَيْسَ ذَاكَ  
لِأَحَدٍ إِلَّا لِلْمُؤْمِنِ، إِنْ أَصَابَتْهُ سَرَاءٌ شَكَرٌ، فَكَانَ خَيْرًا  
لَهُ، وَ إِنْ أَصَابَتْهُ ضَرَاءٌ صَبَرٌ، فَكَانَ خَيْرًا لَهُ.

“Është e çuditshme çështja e Besimtarit, se me të vërtetë e gjithë çështja e tij është mirësi (për të), e kjo nuk është për askënd tjetër përveç Besimtarit: nëse i vjen ndonjë begati, ai falenderon dhe kjo është mirësi për të, dhe nëse e godet ndonjë sprovë, ai bën durim dhe kjo është mirësi për të.”<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> E ka transmetuar Muslimi në Sahihun e tij, nga hadithi i Suhejbit – *radij-Allahu 'anhu* –, në librin “ez-Zuhd uerr-Rrikaak”, tema “E gjithë çështja e besimtarit është mirësi”, hadithi nr. (2999).

Kjo është detyra që ka Besimtari, që të falenderojë Allahun kur është në mirësi dhe begati, në shëndet dhe mirëqenie, për mirësinë e Islamit, për mirësinë e fëmijëve, për mirësinë e pasurisë etj., pra ai duhet ta falenderojë Allahun për ato mirësi duke iu bindur urdhërit të Tij dhe duke braktisur gjërat që Ai ia ka ndaluar.

Ky pra është falenderimi, sikurse ka thënë i Lartësuari:

﴿أَعْمَلُواْ إَلَّا دَأْوِدَ شُكْرًا﴾

**“O familje e Dauudit, bëni falenderime (për Allahun)!”<sup>2</sup>**

Domethënë: t'u bindet urdhërave të Tij, të qëndrojë larg nga gjërat që Ai ia ka ndaluar, t'i shpenzojë mirësitë në bindje

---

<sup>2</sup> Sebe'e, 13.

ndaj Allahut – *SubhaneHu ue Te'ala* –, dhe kur i bien fatkeqësitë si sëmundja, vdekja e djalit apo të afërmët etj., ai duron dhe shpreson shpërblim, nuk pikëllohet, por e mban veten, nuk godet faqet, nuk i shqyen xhepat, nuk bën thirrje të Xhahilijetit, nuk thotë fjalë të pista, por e mban veten dhe duron, si dhe kur bën gjynahe, nxiton që të bëjë teube dhe të kërkojë falje.

## ***Tha autori – Allahu e mëshiroftë –:***

“Dije – Allahu të udhëzoftë në bindjen ndaj Tij – se “el-Hanifijeh” është feja e Ibrahimit. Ajo është që ti ta adhurosh Allahun të vetëm, duke e bërë adhurimin të pastër vetëm për Të. Ai i urdhëroi të gjithë njerëzit me këtë dhe i krijoi ata për këtë, sikurse ka thënë i Lartësuari:

﴿وَمَا خَلَقْتُ الْجِنَّ وَالْإِنْسَ إِلَّا لِيَعْبُدُونِ﴾

“Dhe Unë nuk i kam krijuar xhinët dhe njerëzit përveçse që ata të më adhurojnë Mua të vetëm.”<sup>3</sup>

Kur ta mësosh që Allahu të ka krijuar për ta adhuruar Atë, atëherë dije se

---

<sup>3</sup> Edh-Dharijat, 56.

adhurimi nuk quhet adhurim nëse nuk shoqërohet me Teuhid ashtu sikurse namazi nuk quhet namaz nëse nuk shoqërohet me pastrimin e kërkuar (*et-tahaarah*).

Dhe nëse shirku futet në adhurim, adhurimi prishet, ashtu siç prishet pastërtia nëse hyn në të papastërtia.

Dhe nëse e mësove që shirku kur futet në adhurim e prish atë, i asgjëson të gjitha veprat dhe bërësi i shirkut do të jetë përjetësisht në Zjarr, atëherë do të kuptosh se gjëja më e rëndësishme që e ke për detyrë, është që ta njohësh këtë çështje, në mënyrë që Allahu të të shpëtojë nga kjo rrjetë, e cila është: të bërit shirk Allahut, gjë për të cilën Allahu i Lartësuar ka thënë:

إِنَّ اللَّهَ لَا يَغْفِرُ أَنْ يُشْرِكَ بِهِ وَيَغْفِرُ مَا

دُورَ ذَلِكَ لِمَنْ يَشَاءُ

“Me të vërtetë, Allahu nuk fal që t'i bësh shirk Atij, dhe Ai ia fal çdokujt që Ai dëshiron, të tjerat përveç kësaj.”<sup>4</sup>

Dhe kjo arrihet me njohjen e katër rregullave, të cilat i ka përmendur Allahu i Lartësuar në Librin e Tij.”

---

<sup>4</sup> En-Nisaa` , 116.

*Shpjegimi i dijetarit bujar, ‘Abdul-‘Azijz Ibën Baz – Allahu e mëshiroftë –:*

Pra, nëse Besimtari e mësoi që Teuhidit nëse i hyn shirku, ai prishet, ashtu siç prishet pastërtia nëse ndodh ndonjë papastërti trupore, atëherë ai do të mësojë se gjëja më e rëndësishme që ai e ka për detyrë që ta mësojë është Teuhidi ashtu siç është ai në realitet, si dhe të mësojë shirkun ashtu siç është ai në realitet, në mënyrë që të mos bjerë në shirk dhe t'i asgjësohet, Teuhidi, Feja dhe Islami i tij.

Sepse Teuhidi është Feja e Allahut, ai është Islami, ai është udhëzimi, prandaj nëse bën ndonjë prej llojeve të shirkut, ky Islam asgjësohet, kjo Fe bëhet e pavlerë, si për shembull t'u lutesh të vdekurve dhe të kërkosh ndihmë nga ata, ose të shash fenë, ose të shash Allahun,

ose të shash të Dërguarin – *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* –, ose të tallesh me Allahun, me të Dërguarin – *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* – dhe të tallesh me fenë, të lësh atë që ta ka obliguar Allahu dhe ta bësh hallall me besim atë gjë që Allahu e ka bërë harram dhe që njihet patjetër në këtë fe, siç është zinaja dhe gjërat e tjera si ajo.

Pra, nëse ai vjen me ndonjë gjë prej këtyre anuluesve, Islami i tij do të asgjësohet, njësoj si ai që bën ndonjë prej anuluesve të pastërtisë, siç janë dalja e gazrave, urinimi apo kryerja e nevojës, atij i prishet pastërtia. Kështu është edhe Teuhidi dhe Islami i tij; nëse gjendet tek ai ndonjë anulues, ky Teuhid dhe ky Islam i tij prishet, njësoj si muslimani që shan Allahun dhe fenë dhe tallet me të, ai ka bërë kufër, derisa të pendohet. Po kështu është edhe ai që shan Allahun, ka

bërë kufër, e nëse mohon obligueshmërinë e namazit, ka bërë kufër, kush mohon që zinaja është harram, ka bërë kufër, kush kërkon ndihmë nga të vdekurit dhe zotohet në ata, ka bërë kufër.

Kështu pra, anuluesit e Islamit e prishin atë, ashtu sikurse anuluesit e pastërtisë e bëjnë pastërtinë të pavlerë.

Prej atyre gjërave që të qartësojnë dhe të shpjegojnë realitetin e fesë, është mësimi i këtyre rregullave të cilat kanë ardhur në Librin e Allahut. Prandaj, nëse studion dhe mediton në to, çështja do të të bëhet akoma më e qartë.

*Tha autori – Allahu e mëshiroftë –:*

### Rregulli i Parë:

Se mosbesimtarët të cilët i luftoi i Dërguari i Allahut – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* – e pohonin që Allahu i Lartësuar është Krijuesi dhe Sistemuesi i të gjitha çështjeve, por kjo nuk i futi ata në Islam.

Dhe argument për këtë është Fjala e të Lartësuarit:

﴿قُلْ مَن يَرْزُقُكُمْ مِّنَ السَّمَاءِ وَالْأَرْضِ أَمْنٌ  
يَمْلِكُ السَّمْعَ وَالْأَبْصَرَ وَمَن تُخْرِجُ الْحَىً مِنَ  
الْمَيِّتِ وَتُخْرِجُ الْمَيِّتَ مِنَ الْحَىِ وَمَن يُدَبِّرُ  
الْأَمْرَ فَسَيَقُولُونَ اللَّهُ فَقُلْ أَفَلَا تَتَّقُونَ﴾

“Thuaj: Kush ju sjell furnizim nga qielli dhe nga toka dhe kush është Zotëruesi i të dëgjuarit dhe të shikuarit? Dhe kush e nxjerr të gjallën nga e vdekura dhe të vdekurën nga e gjalla? Dhe kush është Rregulluesi i të gjitha çështjeve? Ata do të thonë: “Allahu.” Thuaju: A nuk po frikësoheni atëherë (nga Ndëshkimi i Allahut, ngaqë i bëni shok Atij në adhurim)?”<sup>5</sup>

---

<sup>5</sup> Junus, 31.

*Shpjegimi i dijetarit bujar, ‘Abdul-‘Azijz Ibën Baz – Allahu e mëshiroftë –:*

Rregulli i parë është që ta dish se mosbesimtarët të cilët i luftoi i Dërguari – *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* – dhe Sahabët – *radij-Allahu 'anhum* – e pohonin Teuhidin Rububijeh: ata e pohonin që Allahu është Krijuesi dhe Furnizuesi i tyre dhe Sistemuesi i çështjeve të tyre, dhe nuk kishin asnjë dyshim tek kjo, kurse injorantët e Muslimanëve sot mendojnë se pohimi i këtij Teuhidi (Rrububijeh) mjafton; nëse pohon që Allahu është Krijuesi dhe Furnizuesi dhe se Ai është Zoti i tij, kjo mjafton (sipas tyre).

Mirëpo kjo është nga injoranca, se kështu atëherë mushrikët dalin më të ditur se këta. Nëse ndonjëri prej tyre e pohon Rububijen dhe thotë:

“Allahu është Zoti im, është Krijuesi im dhe Furnizuesi im”, ai beson se kjo mjafton. Jo! Kjo nuk mjafton.

Pra, mushrikët e pohuan atë, sikurse ka thënë i Lartësuari:

﴿وَلِئِنْ سَأَلْتُهُمْ مَنْ خَلَقَهُمْ لَيَقُولُنَّ اللَّهُ﴾

“Nëse i pyet ata se kush i ka krijuar, me siguri që ata do të thonë:  
“Allahu!”<sup>6</sup>

Dhe Ai thotë:

﴿وَلِئِنْ سَأَلْتُهُمْ مَنْ خَلَقَ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ﴾

﴿وَسَخَّرَ الشَّمْسَ وَالْقَمَرَ لَيَقُولُنَّ اللَّهُ﴾

---

<sup>6</sup> Ez-Zukhruf, 87.

“Nëse ti i pyet ata se kush i ka krijuar qiejt dhe Tokën dhe kush i ka nënshtuar Diellin e Hënën, me siguri që ata do të të thonë: “Allahu!” ”<sup>7</sup>

Pra, mushrikët e pohojnë këtë. Ka thënë i Lartësuari: “**Thuaj**”, domethënë thuaj o Muhamed:

﴿قُلْ مَنْ يَرْزُقُكُمْ مِّنَ السَّمَاءِ وَالْأَرْضِ أَمْنَى  
يَمْلِكُ السَّمْعَ وَالْأَبْصَرَ وَمَنْ تُخْرِجُ الْحَيَّ مِنَ  
الْمَيِّتِ وَتُخْرِجُ الْمَيِّتَ مِنَ الْحَيِّ وَمَنْ يُدَبِّرُ  
الْأَمْرَ فَسَيَقُولُونَ اللَّهُ أَفَلَا تَتَّقُونَ﴾

“Thuaj: Kush ju sjell furnizim nga qelli dhe nga toka dhe kush është Zotëruesi i të dëgjuarit dhe të

---

<sup>7</sup> El-Ankebut, 61.

shikuarit? Dhe kush e nxjerr tē gjallēn nga e vdekura dhe tē vdekurēn nga e gjalla? Dhe kush është Rregulluesi i tē gjitha çështjeve? Ata do tē thonë: “Allahu.” Thuaju: A nuk po frikësoheni atëherë (nga Ndëshkimi i Allahut, ngaqë i bëni shok Atij në adhurim)?”<sup>8</sup>

Përderisa ju i dini këto, a nuk po frikësoheni që po i bëni shirk Allahut, kështu që tē ktheheni në Teuhidin e vërtetë? Ata pra, i dinë këto çështje dhe i pohojnë ato për Allahun, por megjithatë ata nuk u bënë muslimanë dhe ajo që pohonin nuk u bëri dobi, prandaj ata i luftoi Pejgamberi – *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* –, sepse ata nuk e veçuan Allahun me adhurim, por i bënë shok Allahut: Latin, ‘Uzan, Menatin dhe idhujt e tjerë tē shumtë që kishin ata.

---

<sup>8</sup> Junus, 31.

Pra, Teuhidi është që adhurimi t'i kushtohet Allahut të Vetëm, që të besohet se Ai i Vetëm e meriton adhurimin dhe askush tjetër pos Atij. Prej atyre gjërave që ta bëjnë më të qartë këtë është fjala që thonë mushrikët:

“Ne nuk iu lutëm atyre dhe nuk iu drejtoheshim atyre, vetëm se për të kërkuar afrimin dhe ndërmjetësimin.” – siç do të vijë në rregullin e dytë.

*Tha autori – Allahu e mëshiroftë –:*

### Rregulli i Dytë:

Se mosbesimtarët thonë: “Ne nuk u lutemi dhe nuk u drejtohemti atyre veçse që të kërkojmë afrim dhe ndërmjetësim (tek Allahu).” Dhe argument për ndalimin e kërkimit të afrimit nga të vdekurit dhe idhujt është Fjala e të Lartësuarit:

وَالَّذِينَ اتَّخَذُوا مِنْ دُونِهِ أَوْلَيَاءَ مَا نَعْبُدُ هُمْ إِلَّا لِيُقْرَبُونَا إِلَى اللَّهِ زُلْفَى إِنَّ اللَّهَ تَحْكُمُ بَيْنَهُمْ فِي مَا هُمْ فِيهِ تَخْتَلِفُونَ إِنَّ اللَّهَ لَا يَهْدِي مَنْ هُوَ كَذِبٌ كَفَّارٌ

“Dhe ata që marrin për eulija (mbrojtës e ndihmues) të tjerë në vend të Allahut (thonë): “Ne nuk i adhurojmë ata, përveçse që të na afrojnë tek Allahu.” Padyshim që Allahu do të gjykojë mes tyre në lidhje me atë për çfarë patën mosmarrëveshje mes tyre. Vërtet, Allahu nuk e udhëzon atë që është gënjeshtar dhe mosbesimtar.”<sup>9</sup>

Dhe argumenti që hedh poshtë kërkimin e ndërmjetësimit (nga të vdekurit dhe idhujt) është Fjala e të Lartësuarit:

وَيَعْبُدُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ مَا لَا يَضُرُّهُمْ

وَلَا يَنْفَعُهُمْ وَيَقُولُونَ هَؤُلَاءِ شُفَعَاءُنَا عِنْدَ

اللَّهِ

---

<sup>9</sup> Ez-Zumer, 3.

“Dhe ata adhurojnë në vend të Allahut atë ç’ka s’i dëmton dhe as iu bën dobi, dhe thonë: “Këta janë ndërmjetësuesit tanë tek Allahu.””<sup>10</sup>

Ndërmjetësimi është dy llojësh:

Ndërmjetësimi i ndaluar dhe ndërmjetësimi i lejuar.

Ndërmjetësimi i ndaluar është ai i cili kërkohet nga të tjerë përveç Allahut, përgjëra që vetëm Allahu ka fuqi t’i bëjë.

Dhe argument është Fjala e të Lartësuarit:

---

<sup>10</sup> Junus, 18.

يَأَيُّهَا الَّذِينَ ءاْمَنُوا اَنفِقُوا مِمَّا رَزَقْنَاكُمْ مِنْ  
 قَبْلِ اَنْ يَأْتِيَ يَوْمٌ لَا يَبْعَدُ فِيهِ وَلَا خُلْقٌ  
 شَفَعَةٌ وَالْكَفِرُونَ هُمُ الظَّالِمُونَ

“O ju që besoni! Shpenzoni nga ajo  
 me të cilën Ne ju kemi furnizuar, para  
 se të vijë një Ditë kur nuk do të ketë as  
 marrëveshje, as shoqëri dhe as  
 ndërmjetësim. E mosbesimtarët janë  
 Dhalimunë (idhujtarë, zullumqarë,  
 keqbërësa).”<sup>11</sup>

Kurse ndërmjetësimi i pranuar është  
 ai që kërkohet nga Allahu ndërsa  
 ndërmjetësuesi është i nderuar me  
 ndërmjetësimin, kurse ai për të cilin  
 ndërmjetësohet është person, me veprat  
 dhe fjalët e të cilit Allahu është i

<sup>11</sup> El-Bekarah, 254.

Kënaqur, pasi që Ai jep leje, sikurse ka thënë i Lartësuari:

﴿مَنْ ذَا الَّذِي يَشْفَعُ عِنْدَهُ إِلَّا بِإِذْنِهِ﴾

“E kush është ai që mund të ndërmjetësojë tek Ai, përveçse me Lejen e Tij?”<sup>12</sup>

---

<sup>12</sup> El-Bekarah, 255.

*Shpjegimi i dijetarit bujar, ‘Abdul-‘Azijz Ibën Baz – Allahu e mëshiroftë –:*

Domethënë: (mosbesimtarët thonë) ne nuk kishim për qëllim që ata (idhujt) krijojnë apo furnizojnë apo që i sistemojnë çështjet apo që i japid jetë të vdekurve, jo, jo. Ne nuk kishim për qëllim këtë. Ne e dimë që të gjitha këto janë vetëm të Allahut – ‘Azze ue Xhel-le – , mirëpo ne iu drejtuam atyre, që ata të ndërmjetësojnë për ne dhe që të na afrojnë tek Allahu, sepse ata janë më të mirë se ne, janë njerëz fetarë, kanë qenë të bindur dhe me vepra të mira. Prandaj i adhurojmë dhe u lutemi dhe u kërkojmë ndihmë, që ata të na afrojnë tek Allahu dhe që të ndërmjetësojnë për ne, sepse ata janë më të mirë se ne dhe kanë më shumë pozitë se ne. Sikurse ka thënë Allahu – *Xhel-le ue ‘Alaa* – për ta në Kur'an në suren Zumer:

وَالَّذِينَ أَتَخْذُوا مِنْ دُونِهِ أَوْلِيَاءَ مَا  
 نَعْبُدُ هُمْ  
 إِلَّا لِيُقَرِّبُونَا إِلَى اللَّهِ زُلْفَ

“Dhe ata që marrin për eulija (mbrojtës e ndihmues) të tjerë në vend të Allahut (thonë): “Ne nuk i adhurojmë ata, përveçse që të na afrojnë tek Allahu.””<sup>13</sup>

Domethënë: ata thonë “**ne nuk i adhurojmë ata**”, pra Pejgamberët dhe njerëzit e devotshëm, vetëm se, që ata të na afrojnë tek Allahu. Domethënë, ne nuk i adhuruam ata, se ata krijojnë apo

---

<sup>13</sup> Ez-Zumer, 31.

furnizojnë. Jo! Por, ngaqë ata të afrojnë tek Allahu. Ka thënë i Lartësuari:

إِنَّ اللَّهَ تَحْكُمُ بَيْنَهُمْ فِي مَا هُمْ فِيهِ  
يَخْتَلِفُونَ إِنَّ اللَّهَ لَا يَهْدِي مَنْ هُوَ كَذِبٌ  
كَفَّارٌ

“Padyshim që Allahu do të gjykojë mes tyre në lidhje me atë për çfarë patën mosmarrëveshje. Vërtet, Allahu nuk e udhëzon atë që është gënjeshtar dhe mosbesimtar.”<sup>14</sup>

Allahu i quajti ata në këtë ajet “gënjeshtarë e mosbesimtarë”.

Kjo tregon se adhurimi që u bënin atyre me qëllim që të kërkonin afrimin,

---

<sup>14</sup> Ez-Zumer, 3.

është prej kufrit, edhe pse nuk thonin që ata krijonin dhe furnizonin. Nëse iu luten atyre dhe kërkojnë ndihmë prej tyre dhe zotohen në ta dhe bëjnë kurban për ta, me qëllim që të arrijnë afrimin dhe ndërmjetësimin e tyre, ky pikërisht është kufri që bënин mushrikët e parë. Prandaj Allahu i quajti ata gënjeshtarë e mosbesimtarë. Domethënë, ata gënjen me pretendimin e tyre, se ata (idhujt) i afrojnë tek Allahu dhe bënë kufër me këtë.

Thotë Ai që është i Përsosur nga çdo e metë:

وَيَعْبُدُونَ مِنْ دُوْنِ اللَّهِ مَا لَا يَضُرُّهُمْ

وَلَا يَنْفَعُهُمْ وَيَقُولُونَ هَؤُلَاءِ شُفَعَاءُنَا عِنْدَ

اللَّهِ

“Ata adhurojnë në vend të Allahut atë që as nuk u bën dëm, as nuk u sjell dobi dhe thonë: “Këta janë ndërmjetësit tanë tek Allahu.””<sup>15</sup>

Pra, ata e pohuan që të adhuruarit e tyre nuk të bëjnë dobi e as dëm, por megjithatë thonë se ata ndërmjetësojnë pér ta. Pra, ata e pohojnë këtë, kurse Allahu – *Xhel-le ue ‘Alaa* – thotë:

﴿مَا لِلظَّالِمِينَ مِنْ حَمِيمٍ وَلَا شَفِيعٌ يُطَاعٌ﴾

“Pér zullumqarët nuk ka asnje mik tē afërt dhe as ndërmjetësues tē pranueshëm.”<sup>16</sup>

---

<sup>15</sup> Junus, 18.

<sup>16</sup> Gafir, 18.

Dhe ky shirk e anulloi arritjen e ndërmjetësimit për ta dhe ai nuk u bëri dobi atyre, përkundrazi i dëmtoi.

Kurse, ajo që u bën dobi atyre është, që të pendohen tek Allahu dhe të jenë të palëkundur në Teuhid, që ta adhurojnë Allahun të Vetëm dhe të heqin dorë nga të bërit shirk Atij. Kjo është ajo që u bën dobi atyre: që ta veçojnë Allahun (me adhurim), sikurse është edhe kuptimi i fjalës "**La ilahe il-Allah**".

Domethënë: që ta veçojnë Allahun me adhurim: me du'anë, me frikën, me shpresën, me kurbanin, me zotimin, që të gjitha të jenë vetëm për Allahun, e të mos i shoqërojnë Allahut askënd (në adhurim), as ndonjë profet të dërguar, as ndonjë melek të afërt tek Allahu, as ndonjë xhin e asgjë tjetër. Kjo është feja e Allahut.

Pra, mushrikët, ata të cilët i luftoi Pejgamberi – *sal-lAllahu 'alejhi ue sellem* –, vepruan të tillë vepra, domethënë ia kushtuan adhurimin të tjerëve në vend të Allahut. Kurse Teuhidi, Feja dhe Islami është që t'i kushtohet adhurimi Allahut të vetëm dhe askujt tjetër pos Atij.

Edhe nëse dikush pretendon se ai (i adhuruari i tij) nuk krijon, nuk furnizon, përderisa ai i kushtoi atij adhurimin, ka bërë kufër, edhe nëqoftëse beson se ai i adhuruar nuk krijon dhe nuk furnizon. Sepse mushrikët e besonin këtë dhe e dinin që të adhuruarit e tyre nuk krijojnë dhe nuk furnizojnë, por ata janë nevojtarë dhe robër (të Allahut), e megjithatë Allahu nuk i justifikoi ata me këtë gjë, përkundrazi, Ai i shpalli ata qafira ngaqë e kërkuan ndërmjetësimin nga të tjerë në vend të Allahut dhe u

kushtuan atyre adhurime për të kërkuar ndërmjetësimin.

Kështu që, thelbi i diskutimit është se du’aja (lutja) e tyre drejtuar të tjerëve në vend të Allahut, kërkimi i ndihmës nga të tjerët në vend të Allahut dhe kushtimi i disa adhurimeve të tjerëve në vend të Allahut, e bëjnë robin mushrik, edhe nëse ai e pohon që Allahu është Krijuesi, Furnizuesi dhe Sistemuesi i të gjitha çështjeve..., etj., edhe nëse e pohon që të adhuruarit e tyre nuk të bëjnë as dobi e as dëm, porse ai do vetëm ndërmjetësimin e tyre ose kërkon që ata ta afrojnë (tek Allahu).

Pra, kjo nuk e shpëton atë nga shirku.

Atëherë, ai që adhuron Bedeuin apo që adhuron Abdul-Kadir Xhejlanin apo që adhuron të Dërguarin – *sal-lAllahu*

*'alejhi ue sel-lem* – apo që adhuron ndonjë gur apo xhin, e pastaj thotë:

“Unë besoj se ai (që po adhuroj) më afron (tek Allahu), dhe nuk besoj se ai krijon apo furnizon”, atij duhet t’i sqarohet se ky është shirku i madh dhe se kjo është feja që ndiqnin mushrikët.

Thotë Allahu i Lartësuar për ta:

﴿مَا نَعْبُدُ هُمْ إِلَّا لِيُقَرِّبُونَا إِلَى اللَّهِ زُلْفَ﴾

**“Ne nuk i adhurojmë ata përveçse që të na afrojnë tek Allahu.”<sup>17</sup>**

Andaj, ai e ka detyrë që të ruhet nga kjo fe, domethënë nga feja e mushrikëve, duke bërë teube të sinqertë dhe duke u shkëputur totalisht nga shirku, si dhe

---

<sup>17</sup> Ez-Zumer, 3.

duke i mësuar vëllezërit dhe të afërmit e tij dhe njerëzit e shtëpisë së tij që nuk e kanë kuptuar këtë, si dhe të angazhohet dhe të jetë aktiv në përcjelljen e da'uetit dhe të përkujdeset që t'ua bëjë atyre të kuptueshme, se fjala e tyre:

“Që të adhuruarit që ata adhurojnë, i afrojnë tek Allahu” dhe se nuk kanë për qëllim që ata (idhujt) të bëjnë dobi apo dëm, por kanë për qëllim ndërmjetësimin dhe afrimin e tyre (tek Allahu), pikërisht ky është shirku i madh.

Përderisa qëllimi i tyre ishte afrimi dhe ndërmjetësimi i tyre tek Allahu dhe për këtë arsy i kushtuan atyre adhurimin, pikërisht ky është shirku i madh.

*Tha autori – Allahu e mëshiroftë –:*

### Rregulli i tretë

Se Pejgamberi hasi njerëz që ndryshonin nga njëri-tjetri në adhurimin që bënин. Mes tyre kishte njerëz që adhuronin melaiket, disa adhuronin profetët dhe njerëzit e mirë dhe të tjerë adhuronin gurët, pemët, diellin dhe hënën. I Dërguari i Allahut – *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* – i luftoi ata dhe nuk bëri dallim midis tyre.

Dhe argument për këtë është Fjala e të Lartësuarit:

وَقَاتِلُوهُمْ حَتَّىٰ لَا تَكُونَ فِتْنَةٌ وَيَكُونَ الَّذِينُ



**“Dhe luftoji ata derisa të mos mbetet më Fitne** (mosbesim dhe adhurim i të tjerëve bashkë me Allahun) **dhe e gjithë feja** (adhurimi) **të jetë për Allahun** (të Vetëm).”<sup>18</sup>

Dhe argument që dielli dhe hëna (janë adhuruar) është Fjala e të Lartësuarit:

وَمِنْ ءَايَاتِهِ الْأَلْيُونُ وَالنَّهَارُ وَالشَّمْسُ وَالْقَمَرُ

لَا تَسْجُدُوا لِلشَّمْسِ وَلَا لِلْقَمَرِ

**“Dhe prej shenjave të Tij janë dita dhe nata, dielli dhe hëna. Mos i bini në sexhde diellit apo hënës.”**<sup>19</sup>

Dhe argument që melaiket (janë adhuruar) është Fjala e të Lartësuarit:

---

<sup>18</sup> El-Bekarah, 193.

<sup>19</sup> Fussilet, 37.

وَلَا يَأْمُرُكُمْ أَنْ تَتَخِذُوا الْمُلْكِةَ وَالنَّبِيِّنَ

أَرْبَابًا

“As nuk do t’ju urdhéronte që të merrnit melaiket (ëngjëjt) dhe profetët për zota (të adhuruar).”<sup>20</sup>

Dhe argument që profetët (janë adhuruar) është Fjala e të Lartësuarit:

---

<sup>20</sup> Aali-Imran, 80.

**Shënim i përkthyesit:** Ka thënë Ibën Kethiri – *rahimehullah* – në komentimin e këtij fragmenti të ajitet: “As nuk do t’ju urdhéronte që të merrnit melaiket (ëngjëjt) dhe profetët për zota (të adhuruar).” – “Domethënë: as nuk do t’ju urdhéronte që të adhuronit dikë tjeter pos Allahut, as ndonjë profet të dërguar dhe as ndonjë melek të afërt (tek Allahu).”

وَإِذْ قَالَ اللَّهُ يَعْيَسَى ابْنَ مَرْيَمَ إِنَّتَ قُلْتَ  
 لِلنَّاسِ أَتَخِدُونِي وَأُمِّيَ إِلَنَهَيْنِ مِنْ دُونِ اللَّهِ قَالَ  
 سُبْحَانَكَ مَا يَكُونُ لِي أَنْ أَقُولَ مَا لَيْسَ لِي  
 بِحَقٍّ إِنْ كُنْتُ قُلْتُهُ فَقَدْ عَلِمْتَهُ تَعْلُمُ مَا فِي  
 نَفْسِي وَلَا أَعْلَمُ مَا فِي نَفْسِكَ إِنَّكَ أَنْتَ عَلَمُ

الْغُيُوبِ

“Dhe kur Allahu të thotë (në Ditën e Ringjalljes): O ‘Isa, biri i Merjemes! A mos u the ti njerëzve: “Adhuromëni mua dhe nënën time si dy të adhuruar përkrah Allahut.” Ai (‘Isa) do të thotë: “I pastër je Ti! Si mund ta thoja një gjë të tillë kur nuk kisha aspak të drejtë (për ta thënë). Sikur unë ta kisha thënë një gjë të tillë, Ti me siguri do ta dije. Ti e di se çfarë ka brenda meje edhe pse

unë nuk di asgjë se çfarë ka në Ty. Vërtet, Ti je i Gjithëditur për atë që është e fshehtë.”<sup>21</sup>

Dhe argument që njerëzit e mirë (janë adhuruar) është Fjala e të Lartësuarit:

﴿أُولَئِكَ الَّذِينَ يَدْعُونَ يَبْتَغُونَ إِلَىٰ رَبِّهِمُ الْوَسِيلَةَ أَيُّهُمْ أَقْرَبُ وَيَرْجُونَ رَحْمَتَهُ وَنَخَافُونَ عَذَابَهُ﴾

“Ata të cilëve u luten, duan për vetet e tyre rrugë për t’u afruar tek Zoti i tyre, se kush prej tyre do të jetë më i afërti dhe ata shpresojnë për Mëshirën e Tij dhe i frikësohen Ndëshkimit të Tij.”<sup>22</sup>

---

<sup>21</sup> El-Ma`ideh, 116.

<sup>22</sup> El-Israa`, 57.

Dhe argument që gurët dhe pemët (janë adhuruar) është Fjala e të Lartësuarit:

أَفَرَأَيْتُمْ أَلَّا تَوَلِّنَا وَمَنْوَةً الْثَالِثَةَ

الْأُخْرَى

“A nuk po e shikoni ju Latin, ‘Uza-n dhe tjetrin, Menatin, që është i treti (të cilët ju po i adhuroni)?”<sup>23</sup>

---

<sup>23</sup> En-Nexhm, 19-20.

**Shënim i përkthyesit:** Ka thënë Shejkh ‘Abdur-Rrahman Ibën Nasir es-Sa’dij – rahimehullah – në komentimin e këtij ajeti: “I Lartësuari pasi përmendi që Muhamed i – sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem – erdhi me Udhëzimin, me Fenë e Hakut dhe me urdhërin për adhurimin e Allahut me Teuhid, Ai përmendi kotësinë e adhurimit

---

që ata ua kushtonin (idhujve) që nuk kanë asnijë gjë nga cilësitë e përsosmërisë dhe as të bëjnë dobi dhe as të dëmtojnë, porse ato janë vecse emra të zbrazta nga çdo kuptim, me të cilat i quajtën mushrikët dhe baballarët e tyre injorantë e të devijuar. Ata shpikën për idhujt emra të kotë, të cilat nuk i meritonin, kështu mashtruan me to vetet e tyre dhe njerëzit e tjerë të devijuar si puna e tyre. Pra, të adhuruarit që janë në këtë gjendje nuk meritojnë asnijë grimcë prej adhurimit. Këto emra me të cilat i quajtën idhujt, ata pretenduan se janë nxjerrë nga cilësitë që kanë ato: kështu e quajtën Latin nga *el-Ilah*, Ai që e meriton adhurimin; ‘Uza nga emri *el-‘Azijz*; Menati nga *el-Mennan*, duke devijuar rëndë nga Emrat e Allahut dhe duke i bërë shirk Atij! Pra, këto emra janë të zbrazta nga kuptimi, sepse çdokush që ka sadopak logjikë e di se sa të pavërteta janë këto cilësi tek ato idhuj.” [*Tejsiir el-Keriim err-Rrahman fij Tefsiiir Kelami el-Mennan*, fq.975]

Dhe hadithi i Ebu Uakid el-Lejthit –  
*radij-Allahu 'anhu* – i cili ka thënë:

خَرَجْنَا مَعَ النَّبِيِّ – صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ – إِلَى حُنَيْنٍ،  
وَنَحْنُ حُنَيْنٌ أَعْهَدْنَا بِكُفْرٍ، وَلِلْمُشْرِكِينَ سِدْرَةً يَعْكُفُونَ  
عِنْدَهَا وَيُنُودُّونَ بِهَا أَسْلَحَتِهِمْ، يُقَالُ لَهَا: ذَاتُ أَنْوَاتٍ،  
فَمَرَرْنَا بِسِدْرَةِ، فَقُلْنَا يَا رَسُولَ اللَّهِ! اجْعَلْ لَنَا ذَاتَ  
أَنْوَاتٍ، كَمَا لَهُمْ ذَاتٌ (أَنْوَاتٍ).

“U nisëm për në Hunejn me Pejgamberin – sal-lAllahu 'alejhi ue sellem – dhe ne sapo e kishim braktisur mosbesimin (kufrin).<sup>24</sup> Mushrikët kishin një pemë të cilës i përkushtoheshin dhe

---

<sup>24</sup> Fjala “hudethaa 'ahdin bi-kufér” do të thotë ishin afër me kohën kur qenë në kufér, kur kishin dalë nga ai dhe kishin hyrë në Islam, dhe se feja akoma nuk ishte rrënjosur në zemrat e tyre. Shiko librin “en-Nihajeh fij Gariib el-Hadiith uel-Ether” të Ibnul-Ethir, lënda “hadethe”, kapitulli “el-haa me'a ed-daal” (fq.192), botimi i Daar Ibnul-Xheuzij në Rrijad, botimi i dytë, viti 1425 hixhrij.

*varnin<sup>25</sup> në të armët e tyre, të cilën e quanin Dhatu-Enuat.<sup>26</sup> Kaluam pranë një peme të tillë dhe thamë: O i Dërguari i Allahut, na cakto edhe neve një Dhatu-Enuat siç e kanë ata Dhatu-Enuatin e tyre.<sup>27</sup> [Hadithi i njohur]*

---

<sup>25</sup> Fjala “jenutuune” do të thonë i varnin në të armët e tyre për të kërkuar bereqet prej saj dhe si madhërim për të.

<sup>26</sup> Dhatu-Enuat është emri i vetë pemës që kishin mushrikët dhe i varnin në të armët e tyre. Shiko librin “en-Nihajeh fij Gariib el-Hadiith uel-Ether” të Ibnu'l-Ethir, kapitulli “en-nuun me'al-uau”, lënda “neueta” (fq.946).

<sup>27</sup> Transmetuar nga Tirmidhiu në kapitujt e fitneve nga i Dërguari i Allahut – *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* –, kapitulli “Çfarë ka ardhur në lidhje me: *nuk ka dyshim që ju do të ndiqni rrugët e atyre që ishin përpara jush*”, hadithi nr. (2180), dhe tha se hadithi është Hasen Sahih; Ahmedi në *Musnedin* e tij (5/218) dhe Ibën Hibbani në *Sahihun* e tij,

## Rregulli i katërt

Se mushrikët e kohës sonë janë më të këqinj në shirkun e tyre sesa mushrikët që erdhën para tyre. Kjo, sepse ata që erdhën para tyre bënин shirk gjatë kohëve të rehatisë dhe e bënин adhurimin të pastër për Allahun gjatë kohëve të vështira.

Megjithatë, shirku i mushrikëve të kohës sonë është i vazhdueshëm, si në rehati ashtu dhe në vështirësi. Argument është Fjala e të Lartësuarit:

﴿فَإِذَا رَكِبُوا فِي الْفُلُكِ دَعَوْا اللَّهَ مُخْلِصِينَ لَهُ  
الَّدِينَ فَلَمَّا نَجَّهُمْ إِلَى الْبَرِ إِذَا هُمْ يُشْرِكُونَ﴾

---

në librin *et-Tarikh*, me numër (6667). Kurse Ebu Uakid e ka emrin el-Harith Ibën ‘Auf.

“Dhe kur ata hipin në anije, e lusin Allahun duke e bërë besimin e tyre të pastër vetëm për Të, po kur Ai i sjell ata shëndoshë e mirë në tokë, ç’të shohësh! Ata shoqërojnë të tjerët me Allahun në adhurim.”<sup>28</sup>

Mbaroi.

Allahu dhëntë lavdërimë dhe paqe për Pejgamberin tonë, Muhamedin, si dhe për Familjen e tij dhe Shokët e tij.

---

<sup>28</sup> El-Ankebut, 65.

*Shpjegimi i dijetarit bujar, ‘Abdul-‘Azijz Ibën Baz – Allahu e mëshiroftë –:*

Rregulli i tretë dhe i katërt është: se Pejgamberi – *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lém* – erdhi tek njerëz që ndryshonin nga njëri-tjetri në adhurimin që bënин. Pastaj (autori) përmendi rregullin e fundit nga katër rregullat, të cilat kush i arsyeton dhe i kuption ato mirë, e ka kuptuar fenë e mushrikëve dhe e ka kuptuar fenë e Muslimanëve dhe e ka mësuar dallimin midis atyre të dyjave. Ato janë rregulla të rëndësishme dhe të qarta. Autori – Allahu e mëshiroftë – ka qartësuar në to realitetin e shirkut dhe realitetin e gjendjes së mushrikëve dhe ka qartësuar realitetin e thirrjes dhe udhëzimit të Pejgamberit – *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lém* – dhe mesazhit me të cilin e dërgoi Allahu.

Kështu që, kush i kuption këto katër rregulla, ashtu siç duhet, e ka mësuar fenë e mushrikëve me dije të sigurtë dhe e ka mësuar fenë e të Dërguarit me dije të sigurtë.

U përmend në sqarimin e **Rregullit të Parë**, se mushrikët e pohonin Teuhidin Rububijeh dhe se ata nuk e mohonin që Allahu është Krijuesi, Furnizuesi, Sistemuesi, Dhënësi i jetës dhe i vdekjes dhe Furnizuesi i robërve. Ata i dinin këto, prandaj i pohuan kur u pyetën:

﴿وَلِئِن سَأَلَتْهُم مَنْ خَلَقَهُمْ لَيَقُولُنَّ اللَّهُ﴾

“Nëse i pyet ata kush i krijoi, ata padyshim që do të thonë: Allahu!”<sup>29</sup>

Siç u përmend më pérpara:

---

<sup>29</sup> Ez-Zukhruf, 87.

قُلْ مَنْ يَرْزُقُكُمْ مِّنَ السَّمَاءِ وَالْأَرْضِ أَمْ  
 يَمْلِكُ السَّمْعَ وَالْأَبْصَرَ وَمَنْ تُخْرِجُ الْحَيَّ مِنَ  
 الْمَيِّتِ وَتُخْرِجُ الْمَيِّتَ مِنَ الْحَيِّ وَمَنْ يُدَبِّرُ  
 الْأَمْرَ فَسَيَقُولُونَ اللَّهُ فَقُلْ أَفَلَا تَتَّقُونَ

“Thuaj: Kush ju sjell furnizim nga  
 qielli dhe nga toka dhe kush është  
 Zotëruesi i të dëgjuarit dhe të  
 shikuarit? Dhe kush e nxjerr të gjallën  
 nga e vdekura dhe të vdekurën nga e  
 gjalla? Dhe kush është Rregulluesi i të  
 gjitha çështjeve? Ata do të thonë:  
 “Allahu.” Thuaju: A nuk po frikësoheni  
 atëherë (nga Ndëshkimi i Allahut, ngaqë  
 i bëni shok Atij në adhurim)?”<sup>30</sup>

---

<sup>30</sup> Junus, 31.

Dhe ai sqaroi në **Rregullin e Dytë** se ata thonë: “Ne nuk iu lutemi atyre dhe nuk iu drejtohem i atyre veçse që të kërkojmë afrimin dhe ndërmjetësimin.”

Domethënë: ata nuk iu drejtuan atyre duke besuar që ata krijojnë apo furnizojnë, jo.

Ata e dinë që Krijuesi dhe Furnizuesi është Allahu, mirëpo ata i adhuruan duke shpresuar ndërmjetësimin dhe afrimin e tyre, që ata t'i afronin tek Allahu.

Thotë Allahu i Lartësuar duke përcjellë atë që thanë gjuhët e tyre:

﴿مَا نَعْبُدُ هُمْ إِلَّا لِيُقَرَّبُونَا إِلَى اللَّهِ زُلْفَى﴾

“Ne nuk i adhurojmë ata përveçse që  
të na afrojnë tek Allahu.”<sup>31</sup>

﴿وَيَقُولُونَ هَؤُلَاءِ شُفَعَوْنَا عِنْدَ اللَّهِ﴾

“Dhe ata thonë: “Ata janë  
ndërmjetësuesit tanë tek Allahu.””<sup>32</sup>

Pikërisht ky është shirku i tyre. Ata thonë: ne iu lutëm atyre dhe iu drejtuam atyre që të na afrojnë tek Allahu, që të ndërmjetësojnë për ne tek Allahu, dhe Allahu – *SubhaneHu ue Te’ala* – është Furnizuesi dhe Krijuesi.

Kurse shirku i mushrikëve të mëvonshëm është i përhershëm, kur janë në rehati dhe kur janë në vështirësi, me pejgamberët e me të tjerë veç tyre.

---

<sup>31</sup> Ez-Zumer, 3.

<sup>32</sup> Junus, 18.

E ndonjëri prej tyre madje bën shirk edhe në Rububijeh dhe beson se disa dijetarë dhe disa njerëz të devotshëm kanë kontroll mbi universin dhe mbi lëvizjet e njerëzve. Kjo është nga marrëzia e mendjeve dhe devijimi i intelekteve, kështu që u bënë më të marrë e më të trashë se mushrikët e hershëm, dhe shirku i tyre është më i madh se shirku i mushrikëve të hershëm.

U përmend ndërmjetësimi më pérpara me detaje dhe se ndërmjetësimi është dy llojësh:

Ndërmjetësimi i kënaqshëm (i lejuar), që është ai të cilin e ka lejuar Allahu dhe është i Kënaqur me të, siç është ndërmjetësimi i Pejgamberit – *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* – për ata të cilët presin të gjykohen, derisa të gjykohet mes tyre me Lejen e Allahut të Përsosur

nga çdo e metë, si dhe ndërmjetësimi i tij për njerëzit e Teuhidit, derisa të hyjnë në Xhenet me Lejen dhe Kënaqësinë e Allahut – *SubhaneHu ue Te’ala*.<sup>33</sup>

Dhe ndërmjetësimi i pavlerë (i ndaluar), që është ai të cilin e kërkojnë mushrikët nga të tjera në vend të Allahut, e kërkojnë nga pejgamberët apo nga njerëzit e devotshëm apo nga melaiket apo nga pemët dhe gurët.

---

<sup>33</sup> Kjo është një pjesë nga hadithi i gjatë e i famshëm i ndërmjetësimit, transmetuar nga Bukhari dhe Muslimi, nga Enesi – *radij-Allahu ‘anhu* –: e ka transmetuar Bukhari në librin e Teuhidit, kapitulli: “*Fjala e Zotit të Madhëruar e të Lartësuar Ditën e Kijamitet, me Pejgamberët dhe të tjerët*”, me numër (7510), dhe Muslimi në librin e Imanit, kapitulli: “*Banorët e Xhenetit me gradën më të ulët në të*”, me numër (193).

Ky është ndërmjetësimi i pavlerë, për të cilin ka thënë Allahu i Lartësuar:

﴿فَمَا تَنْفَعُهُمْ شَفَاعَةُ الْشَّافِعِينَ﴾

“Dhe atyre nuk u bën dobi ndërmjetësimi i ndërmjetësuesve.”<sup>34</sup>

Dhe thotë i Lartësuari:

﴿مَا لِلظَّالِمِينَ مِنْ حَمِيرٍ وَلَا شَفِيعٍ يُطَاعُ﴾

“Për zullumqarët nuk ka asnje mik të afërt dhe as ndërmjetësues të pranueshëm.”<sup>35</sup>

Ky pra është ndërmjetësimi i pavlerë, sepse ata e kërkuan atë nga të tjerë në

---

<sup>34</sup> El-Muddeththir, 48.

<sup>35</sup> Gafir, 18.

vend të Allahut, dhe morën shirkun si mjet për të arritur tek ai, prandaj ai (ndërmjetësim) u bë i pavlerë.

Pastaj ai përmendi në **Rregullin e Tretë** se Pejgamberi – *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* – erdhi tek njerëz që ndryshonin në adhurimin e tyre nga njëri-tjetri, kishte grupe dhe lloje. Mes tyre kishte të atillë që adhuronin pejgamberët, mes tyre kishte të atillë që adhuronin melaiket, mes tyre kishte të atillë që adhuronin njerëzit e devotshëm, mes tyre kishte të atillë që adhuronin xhinët, mes tyre kishte të atillë që adhuronin pemët dhe gurët, mes tyre kishte të atillë që adhuronin diellin dhe hënën, pra grupe të ndryshme. Që të gjithë i luftoi Pejgamberi – *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* – dhe i luftuan Sahabët, dhe nuk bënë dallim midis tyre. Dhe ai

përmendi ajetet që e vërtetojnë këtë, siç  
është Fjala e Allahut – *Xhel-le ue ‘Alaa* –:

وَلَا يَأْمُرُكُمْ أَنْ تَتَّخِذُوا الْمُلَائِكَةَ وَالنَّبِيِّنَ  
أَرْبَابًا أَيَّامُرُكُمْ بِالْكُفْرِ بَعْدَ إِذْ أَنْتُمْ مُسْلِمُونَ

“Ai nuk ju urdhëron që melaiket dhe  
pejgamberët t’i merrni për zota (të  
adhuruar). Vallë, si mund t’ju  
urdhërojë kufrin (mosbesimin), pasi i  
jeni nënshtuar Allahut?!”<sup>36</sup>

Pra, Ai e bëri adhurimin e melaikeve  
dhe pejgamberëve kufër.

Dhe Ai ka përmendur në ngjarjen e  
Isait dhe Kristianëve:

---

<sup>36</sup> Aali-Imran, 80.

مَا قُلْتُ لَهُمْ إِلَّا مَا أَمْرَنَّنِي بِهِ أَنْ أَعْبُدُوا إِلَهَهُمْ  
 تَبِّعِي وَرَبِّكُمْ وَكُنْتُ عَلَيْهِمْ شَهِيدًا مَا دُمْتُ فِيهِمْ  
 فَلَمَّا تَوَفَّيْتَنِي كُنْتَ أَنْتَ الْرَّقِيبُ عَلَيْهِمْ وَأَنْتَ  
 عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ شَهِيدٌ

“Unë nuk u kam thënë asgjë tjetër,  
 përveç asaj që më ke urdhëruar Ti:  
 “Adhuroni Allahun, Zotin tim dhe  
 Zotin tuaj.” Kam qenë dëshmitar, për  
 sa kohë që kam jetuar midis tyre dhe,  
 qëkurse më more mua, vetëm Ti ishe  
 Mbikëqyrësi i tyre. Ti je Dëshmitar për  
 ç’do gjë.”<sup>37</sup>

Dhe ka thënë për pemët, gurët dhe  
 njerëzit e devotshëm, po ashtu:

---

<sup>37</sup> El-Ma`ideh, 117.

أَفَرَءَيْتُمْ أَلَّا تَسْمَعُونَ  
وَمَنْوَةً أَلَّا تَلِهَّى  
الْآخَرَيْنَ

“A nuk po e shikoni ju Latin, ‘Uza-n  
dhe tjetrin, Menatin, që është i treti (të  
cilët ju po i adhuroni)?”<sup>38</sup>

Lati ishte një burrë i devotshëm,  
Menati ishte një gur, kurse ‘Uza ishte një  
pemë.

Qëllimi është se mushrikët  
ndryshonin nga njëri-tjetri në adhurimet  
që i bënин për të tjerët në vend të  
Allahut; prej tyre kishte që adhuronin  
diellin dhe hënën, disa të tjerë adhuronin  
yjet, disa të tjerë adhuronin xhinët dhe  
gjëra të tjera.

---

<sup>38</sup> En-Nexhm, 19-20.

Dhe ata i luftoi i Dërguari – *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* – dhe i luftuan Sahabët, dhe nuk bënë dallim midis tyre.

Pra, shirku është një, edhe nëqoftëse ndryshojnë të adhuruarit.

Kështu që, kush adhuron diellin apo hënën apo melaiket apo pejgamberët apo të devotshmit apo yjet apo gjëra të tjera, të gjithë janë mushrikë, qoftë i adhuruari i devotshëm apo send apo pejgamber apo melek (ëngjëll) apo ndonjë gjë tjetër. Thotë Allahu – *Xhel-le ue 'Alaa* –:

وَمَا أُمِرْوا إِلَّا لِيَعْبُدُوا اللَّهَ مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ

“Dhe ata nuk u urdhëruan vetëm se që ta adhurojnë Allahun duke qenë të

sinqertë dhe duke e bërë adhurimin  
vetëm për Të.”<sup>39</sup>

﴿وَقَضَىٰ رَبُّكَ أَلَا تَعْبُدُوا إِلَّا إِيَّاهُ﴾

“Dhe ka urdhëruar Zoti yt që ti të  
mos adhurosh askënd tjetër pos Tij.”<sup>40</sup>

﴿فَاعْبُدِ اللَّهَ مُخْلِصًا لَهُ الْدِينَ﴾

“Adhuroje Allahun me sinqueritet  
dhe bëje adhurimin vetëm për Të.”<sup>41</sup>

﴿فَإِلَّا هُكُمُ اللَّهُ وَحْدَهُ﴾

“I Adhuruari juaj është Një i  
adhruuar i vetëm.”<sup>42</sup>

---

<sup>39</sup> El-Bejjineh, 5.

<sup>40</sup> El-Israa` , 23.

<sup>41</sup> Ez-Zumer, 2.

Andaj, kush i kundërshton këto ajete  
dhe ato që kanë ardhur me të njëjtin  
kuptim me to, ka bërë shirk, qoftë nëse ia  
kushton adhurimin pejgamberëve apo të  
devotshmëve apo melaikeve apo xhinëve  
apo yjeve apo diellit apo hënës apo  
gjërave të tjera, prandaj Allahu – *Xhel-le*  
*ue 'Alaa – zbriti për ta (ajetin):*

وَقَاتِلُوهُمْ حَتَّىٰ لَا تَكُونَ فِتْنَةٌ وَيَكُونُ ﴿١﴾

الَّذِينَ كُلُّهُمْ لِلَّهِ الْعَلِيِّ ﴿٢﴾

“Andaj luftojini ata, derisa të mos  
ketë më fitne...” – domethënë shirk –  
“...dhe të jetë feja e gjithë për  
Allahun.”<sup>43</sup>

---

<sup>42</sup> El-Haxh, 34.

<sup>43</sup> El-Enfal, 39.

Pra, shirkut i thuhet edhe fitne,  
sikurse ka ardhur në Fjalën e të  
Lartësuarit:

وَقَاتِلُوهُمْ حَتَّىٰ لَا تَكُونَ فِتْنَةً

“Andaj luftojini ata, derisa të mos  
ketë më fitne...”

Domethënë: derisa të mos bëhet më  
shirk ndaj Allahut dhe që të jetë e gjithë  
feja për Allahun.

Edhe mosmarrëveshja (*el-ikhtilaf*)  
quhet fitne, edhe gjynahet quhen fitne,  
mirëpo këtu (tek ky ajet) fitneja është  
shirku ndaj Allahut, sikurse ka thënë  
Allahu – *Xhel-le ue ‘Alaa –*:

يَسْأَلُونَكَ عَنِ الْهَرَامِ قِتَالٍ فِيهِ قُلْ  
قِتَالٌ فِيهِ كَبِيرٌ

“Të pyesin ty për muajin e shenjtë, për luftën në të. Thuaju: Luftimi në atë kohë është gjynah i madh...”

Pastaj Ai tha:

وَاصْدُّ عَنْ سَبِيلِ اللَّهِ وَكُفُرُهُ وَالْمَسْجِدِ  
الْحَرَامِ وَإِخْرَاجُ أَهْلِهِ مِنْهُ أَكْبَرُ عِنْدَ اللَّهِ

“...por pengimi i njerëzve prej udhës së Allahut, mohimi i Tij, pengimi i njerëzve nga vizita e Xhamisë së Shenjtë dhe dëbimi i banorëve të saj nga ajo, janë gjynah më i madh tek Allahu.”

Pastaj Ai tha:

وَالْفِتْنَةُ أَكْبَرُ مِنَ الْقَتْلِ

“Kurse fitneja është gjynah më i madh se vrasja.”<sup>44</sup>

Domethënë: shirku.

Pra, fitneja është shirku, i cili është më i madh sesa vrasja. Që njeriu të vrasë një person, ky është një krim i madh dhe një e keqe e madhe, mirëpo që ai t'i bëjë shirk Allahut, kjo është akoma më e madhe sesa vrasja, Allahu na dhëntë mirëqenie.

Kjo tregon se detyra e udhëheqësve është që t'i luftojnë ata që adhurojnë të tjerë në vend të Allahut, absolutisht, kushdo goftë ai që adhurohet.

---

<sup>44</sup> El-Bekarah, 217.

Nëse i thërrasin tek Allahu dhe i orientojnë, porse ata nuk pranojnë, atëherë bëhet detyrë luftimi i tyre, kur ka fuqi për këtë:

﴿فَاتَّقُوا اللَّهَ مَا أَسْتَطَعْتُمْ﴾

“Kjeni frikë Allahun (duke zbatuar urdhërat e Tij) sa të keni mundësi.”<sup>45</sup>

Sikurse ka thënë i Lartësuari:

﴿وَقَاتِلُوهُمْ حَتَّىٰ لَا تَكُونَ فِتْنَةٌ وَيَكُونَ

﴿الَّذِينُ كُلُّهُمْ لِلَّهِ حُلُومٌ﴾

“Luftojini ata, derisa të mos ketë më fitne dhe të jetë feja e gjithë për Allahun.”<sup>46</sup>

---

<sup>45</sup> Et-Tegabun, 16.

Dhe thotë Allahu – *Xhel-le ue 'Alaa* –:

﴿أَنفِرُوا حِفَا فَا وَثَقَالاً وَجَهْدُوا بِأَمْوَالِكُمْ  
وَأَنفُسِكُمْ فِي سَبِيلِ اللَّهِ ذَلِكُمْ خَيْرٌ لَكُمْ إِن  
كُنْتُمْ تَعْلَمُونَ﴾

“Dilni në luftë, qoftë ajo e lehtë apo e rëndë, dhe bëni xhihad me pasuritë dhe vetet tuaja në Rrugën e Allahut. Kjo është më e mirë për ju, nëse e dini.”<sup>47</sup>

Dhe thotë Allahu – *Xhel-le ue 'Alaa* –:

---

<sup>46</sup> El-Enfal, 39.

<sup>47</sup> Et-Teubeh, 41.

يَأَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُواْ هَلْ أَدْلُكُمْ عَلَىٰ تَحْرِةٍ  
 تُنْجِيْكُمْ مِنْ عَذَابٍ أَلِيمٍ ﴿١﴾ تُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ  
 وَرَسُولِهِ وَتُجْهِدُونَ فِي سَبِيلِ اللَّهِ بِاِيمَانِكُمْ  
 وَأَنْفُسِكُمْ ذَلِكُمْ حَيْرٌ لَكُمْ إِنْ كُنْتُمْ تَعْلَمُونَ

“O ju që besoni, a t’ju tregoj për një  
 tregti, e cila ju shpëton nga Dënimi i  
 Dhembshëm? Të besoni Allahun dhe të  
 Dërguarin e Tij dhe të bëni xhihad në  
 Rrugën e Tij, me pasuritë dhe me vetet  
 tuaja. Kjo është më e mirë për ju, nëse e  
 dini.”<sup>48</sup>

Në lidhje me adhurimin e gurëve dhe  
 pemëve ka ardhur hadithi i Ebij Uakid  
 el-Lejthij – *radij-Allahu ‘anhu* –, kur ata  
 dolën me Pejgamberin – *sal-lAllahu*

<sup>48</sup> Es-Saff, 10-11.

*'alejhi ue sel-lem* – për në Hunejn. Ata sapo kishin dalë nga kufri dhe ishin të rinj në Islam, dhe kaluan pranë disa njerëzve nga mushrikët, të cilët adhuronin një pemë lotusi (sidr), e madhëronin dhe varnin armët në të dhe thoshin: “Nëse arma varet në të, ajo do të jetë më jetëgjatë dhe më e fortë.” Muslimanët thanë: “Na bëj edhe neve një Dhatu-Enuat, ashtu siç kanë ata Dhatu-Enuatin e tyre.” Atëherë tha Pejgamberi – *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* –:

الله أكبير إنها السنن قلتم! و الذي نفسي بيده، كما قال  
بنو إسرائيل لموسى:

“Allahu Ekber! Kjo që thatë është nga rrugët (e popujve të mëparshëm)! Pasha Atë në Dorën e të Cilit është shpirti im, thatë ashtu siç i thanë Beni Israilët Musait:

﴿أَجْعَلْ لَنَا إِلَهًا كَمَا لَهُمْ إِلَهٌ﴾

“Na bëj edhe neve një të adhuruuar, ashtu siç kanë ata të adhuruarit e tyre.”<sup>49</sup>

Pra, ai e konsideroi bërjen e pemës objekt adhurimi, të njëjtë me fjalën që thanë Beni Israilët: “Na bëj edhe neve një të adhuruuar, ashtu siç kanë ata të adhuruarit e tyre.”

Nëse do të kishin thënë: “Duam edhe ne një pemë që ta adhurojmë ose ndonjë gur që ta adhurojmë ose ndonjë varr që ta adhurojmë, që të varim armët në të, që t'i lutemi, që të kërkojmë ndihmë nga ai, që të zotohem i në të, atëherë kjo është njësoj si fjala e Beni Israilëve:

---

<sup>49</sup> El-E'araf, 31.

﴿أَجْعَلْ لَنَا إِلَهًا كَمَا لَهُمْ إِلَهٌ﴾

“Na bëj edhe neve një të adhuruar, ashtu siç kanë ata të adhuruarit e tyre.”<sup>50</sup>

Ky është një rregull madhështor, bashkë me dy rregullat e tjerë përpara tij.

Pastaj ai sqaroi **Rregullin e Katërt**, se shirku i të parëve është më i lehtë se i atyre të mëvonshmëve. Pra, shirku i të mëvonshmëve është më i madh dhe më i shëmtuar.

Të parët e bënин shirkun kur ishin në rehati, ndërsa kur ishin në vështirësi e bënин adhurimin të pastër vetëm për Allahun, kurse këta mushrikët (e mëvonshëm), në shumicën e vendeve e

---

<sup>50</sup> El-E’araf, 138.

kanë shirkun tē pérhershëm, në mirësi e në vështirësi, siç janë adhuruesit e Bedeuiut, adhuruesit e Husejnit, adhuruesit e Shejkh ‘Abdul-Kadir Xhejlanit etj.; shirku i tyre është i vazhdueshëm, në rehati e në vështirësi.

Kështu që, është detyrë që tē paralajmërohet kundër shirkut që bëjnë mushrikët në rehati e në vështirësi, i fshehtë apo i qartë qoftë.

Prej argumenteve që tregojnë se mushrikët bëjnë shirk kur janë në rehati dhe jo kur janë në vështirësi, është Fjala e tē Lartësuarit:

﴿فَإِذَا رَكِبُوا فِي الْفُلْكِ﴾

“E kur hipin në anije...”

Domethënë kur hipin në varkën e lundrimtit:

﴿دَعُوا اللَّهَ مُحْلِسِينَ لَهُ الْدِينَ﴾

“Ata i luten Allahut duke e bërë adhurimin të pastër pér Të.”<sup>51</sup>

Domethënë: e bënë du'anë të pastër pér Allahun, ngaqë kishin frikë se mos mbyten në det ose mos u përmbysej anija dhe mbyteshin. Dhe në këto momente ata e bënин adhurimin të pastër pér Allahun. Ndërsa, kur Allahu i shpëton dhe i nxjerr në tokë, ata kthehen prapë tek shirku, Allahu na ruajtë. Kurse në ajetin tjetër thotë Allahu – *Xhel-le ue 'Alaa -*:

---

<sup>51</sup> El-Ankebut, 65.

وَإِذَا مَسَكُمُ الظُّرُفُ فِي الْبَحْرِ ضَلَّ مَنْ تَدْعُونَ  
إِلَّا إِيَاهُ فَمَمَّا نَجَّنَكُمْ إِلَى الْبَرِّ أَعْرَضْتُمْ

“Kur juve ju godet fatkeqësia në det, humbin ata që ju i adhuronit në vend të Atij. Por, pasi Ai ju shpëton në tokë, ju i ktheni shpinën.”<sup>52</sup>

وَإِذَا غَشَّيْتُمْ مَوْجًّا كَالظُّلَلِ دَعَوْا اللَّهَ مُحْلِصِينَ  
لَهُ الدِّينَ

“Kur ata i mbulon dallga si hijet, i luten Allahut duke e bërë adhurimin të pastër për Të.”<sup>53</sup>

---

<sup>52</sup> El-Israa` , 67.

<sup>53</sup> Lukman, 32.

Kështu është gjendja e mushrikëve kur janë në vështirësi: e bëjnë adhurimin të pastër për Allahun dhe e dinë që Ai është Shpëtuesi në vështirësi dhe se Ai është i Adhuruari me hak e askush tjetër. Por kur gjejnë rehatinë e tyre, ata bien në shirk me të adhuruarit dhe idhujt e tyre.

Kurse mushrikët e kohëve tonë, sot, e kanë shirkun të vazhdueshëm.

Ata nuk kanë mençuri, adhurojnë të tjerë në vend të Allahut kur janë në rehati dhe kur janë në vështirësi.

Ata s'bëjnë dallim për shkak të intelekteve të dobëta dhe ngaqë i ka pushtuar injoranca.

Lusim Allahun që të na japë shëndet e mirëqënie. Allahu u dhëntë sukses të gjithëve.

Allahu i dhëntë lavdërime dhe paqe  
Pejgamberit tonë, Muhamedit, si dhe  
Familjes dhe Shokëve të tij.

2 Dhul-Hixheh 1436 Hixhrij /16 Shtator 2015  
Miladij

Përktheu: Alban Malaj  
'Auali, Mekkeh

## Përbajtja:

Parathënie.....	4
Tre shenjat e lumturisë.....	6
“el-Hanifijeh” është feja e Ibrahimit.....	12
Rregulli i parë.....	18
Rregulli i dytë.....	25
Rregulli i tretë .....	40
Rregulli i katërt.....	49